

PËRMBAJTJA:

Hyrje	3
Islami është kundër besëtytnive të kota.....	6
Njësimi i Allahut	15
Kuptimi i jetës.....	18
Dita e gjykimit.....	25
Ndikimi që ka besimi në ditën e gjykimit në jetën e muslimanit.....	26
Vdekja	28
Varri.....	29
Ringjallja dhe tubimi	31
Gjykimi	32
Xheneti.....	34
Pse jam musliman?.....	37
Karvani i të penduarve	43

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

HYRJE

LAVDËRIMET I TAKOJNË VETËM ALLAHUT, Zotit të botëve. Mëshira dhe bekimet e Tij qofshin për të Dërguarin e Allahut, Muhamedin, për shokët e tij dhe për të gjithë ata që ndjekin rrugën e tyre.

Në mesin e shumë qytetërimeve që njohu njerëzimi, qytetërimi islam është ndër më të rëndësishmit për shumë arsye, po për më shumë për atë që i ofroi shoqërisë njerëzore, pasojat e së cilës *-modernizimi, shkenca, zhvillimi-* i mbeten gjithmonë borxhlinj.

Islami është pishtar që ndriçon rrugën e vërtetë, pa eksese dhe gjithnjë i përmbajtur. Ai i kushton rëndësi të veçantë lirisë së individit dhe të drejtave njerëzore në shoqëri. Islami është inkurajues dhe nxitës për dituri, arsim dhe zhvillim, është tepër vigjilent dhe e ruan barazinë midis materies dhe qenies, duke mos lejuar që të cënohen këto ekuilibra në asnjë mënyrë.

Themeli i fesë Islame është *monoteizmi*, njësimi i Zotit, e çdokush që e ndjen këtë monoteizëm, le ta dijë se është duke bartur besimin më progresiv, besimin i cili ndihmoi në ngritjen dhe përparimin e civilizimeve. Ky monoteizëm paraqiti në shkallën më të lartë përsosmërinë, nderoi racionalen dhe inkurajoi për të panjohurat, derisa i bëri të njohura.

Islami është fe legjislative që ka për destinacion ngritjen e mirëqenies. *Është fe mirënjohëse, prandaj nuk i shlyen mirësitë e popujve e as veçoritë e bashkësive.* Ai e ruan kulturën e çdo lloj civilizimi dhe i këshillon ata të cilët e kundërshtojnë ekzistimin e Allahut, që të jenë të përmbajtur dhe i fton për debate madje edhe në parimet më të thella të besimit, sepse feja e vërtetë duhet të ketë edhe argumentet e pamohueshme dhe bindëse. Kjo fe na mëson të jemi të hapur ndaj çdokujt që është i interesuar t'a njohë.

Pikërisht për të gjitha këto këshillojmë veçanërisht udhëheqësit e mediave, që të mos i shtrembërojnë qëllimisht parimet Islame për përfitime të ulëta.

Shikuar nga ky këndvështrim, lindi ideja për përpilimin e këtij libërthi, i cili përmban tema që trajtojnë disa çështje bazë të besimit islam. Qëllimi i këtyre materialeve është që njerëzve t'u sqarohet se çfarë në të vërtetë është Islami dhe në çfarë vlerash aspiron.

Shpresojmë se argumentet Kuranore dhe faktet logjike që paraqiten në këto tema do të jenë të mjaftueshme për t'u bindur se vetëm *te Krijuesi duhet të kthehemi për çdo nevojë tonën, se vetëm tek Ai do të gjejmë prehjen dhe lumturinë e vërtetë dhe se çdo gjë përveç Tij është një mirazh.*

ISLAMI ËSHTË KUNDËR BESËTYTNIVE TË KOTA

Shekulli XXI: Ç'thonë yjet për ju sot?

HOROSKOPI NA DHËNKA përgjigjen e pyetjeve në *televizion*, *radio* dhe *gazeta*! Nuk janë të paktë ata të cilët besojnë se vërtet Afërdita, Marsi etj., mund t'u tregojnë të ardhmen, t'u tregojnë se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë nuk duhet të bëjnë. Këtyre gjërave u besojnë burra dhe gra, të rinj e të reja, mjekë e të sëmurë, mësues e nxënës, të pasur dhe të varfër.

Shpesh të shohin sytë njerëz të ulur pranë fallxhoreve, të cilat, kundrejt një pagese simbolike, u 'tregojnë' të ardhmen! Është fare e thjeshtë: mjafton t'u tregosh pëllëmbën e dorës.

Nuk janë të pakta as ato gra, të cilat, pasi shijojnë kafënë e ngrohtë, presin me padurim që njëra të marrë filxhanët e "t'u lexojë të ardhmen". Por herë pas here dalin edhe 'profetë', të cilët me 'mrekullitë'

dhe ‘parashikimet’ e tyre qesharake çorientojnë mendjet e njerëzve të paformuar.

Kur hipën në ndonjë autobus interurban, diku, në mes të rrugës, përpara apo pranë një tyrbeje, teqeje a varri të ashtuquajtur të mirë, qëllon të të thonë të ngrihesh në këmbë. Ndodh që autobusi të ndalojë edhe plotësisht. E, njerëz të cilët nuk duken aspak jonormalë lënë pas tyrbet, teqetë, varret dhe vendet e ashtuquajtura të mira duke shpresuar prej tyre mbarësi në punë, në udhëtim, fat etj..

Thonë se janë fjalë plakash, por nuk janë vetëm plakat që u besojnë këtyre fjalëve: Mos bëni udhëtime të gjata! Mos ndërmerreni punë të rëndësishme! *Është ditë ‘pa fat’, është e martë! Po doli macja e zezë në rrugë, ndalo!* Po more bukë nga shtëpia dhe nuk e ha, mos e kthe, se të kthehet nusja! *Tu thye pasqyra, 7 vjet do të kesh fatkeqësi! T’u derdh kripa, prit fatin e keq!*

Një letër poshtë derës thotë se në qoftë se nuk e beson çfarë thuhet në të dhe nuk bën 20 kopje, do të të ndodhë fatkeqësi! Një lule e “shenjtë” që duhet ujitur me çaj dhe që nuk duhet shikuar për një javë na plotësuaka çdo dëshirë!

Dikush niset për një punë me mosbesim, duke thënë me vete: “S’më ecën!” ose “Punët e mia shkojnë keq!”, apo “A thua, a ka njeri më fatkeq se unë?!”

Dikush e lidh mossuksesin me persona, me zëra kafshësh apo shpendësh, me lëvizje sysh apo me ndonjë fjalë etj..

Mund të përmendim shumë e shumë kotësi të tilla, po le t’i kthehemi temës sonë dhe të pyesim veten: A mundet një yll, një filxhan kafeje etj., të të tregojë të ardhmen?! Të të thotë atë që nuk dihet?! A mundet që një i vdekur, sado i mirë të ketë qenë, të të sjellë mbarrësi, kur i drejtohesh atij?!

Kotësia e “ditëve të pafata” dhe e “shenjave që sjellin fatkeqësi” do të dukej edhe më e qartë nëse do t’i ktheheshim origjinës së tyre.

Ç’thotë Islami për këto? Besime të tilla u ngjajnë besimeve të idhujtarëve para Islamit. Ata e shihnin të ardhmen e tyre te fallxhorët. Për punë, për udhëtime e të tjera ata i linin shigjetat a zogjtë që të vendosnin, në vend që të vendosnin ata vetë. Prandaj jo më kot koha e tyre është quajtur “koha e injorancës”.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Është ndaluar ta kërkonit fatin me short. Kjo është mëkat ndaj Allahut.” (Kuran, 5:3)

I Dërguari Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, e ka ndaluar që të ndiqen idhujtarët në zakonet e tyre. Në një hadith ai thotë: *“Kush përpiqet që t’i ngjajë një populli, është prej tyre.”*

Besime të tilla, megjithëse duken të vogla, janë rrugë që shkatërrojnë themelin e besimit të muslimanit në një Zot. Besime të tilla mund të ndryshojnë nga koha në kohë dhe nga vendi në vend, por emëruesi i tyre mbetet gjithmonë një: shirku (t’i shoqërohet Zotit ortak në adhurime).

Për shenjat e fatit dhe për parandjenjën e keqe i Dërguari, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë tri herë: *“Besimi në to është shirk.”* (Transmeton Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe)

Gjithçka e mirë apo e keqe është përcaktuar nga Allahu. Allahu i Madhëruar thotë:

“Nuk ndodh asnjë fatkeqësi, as në tokë dhe as në trupin tuaj, që të mos jetë shënuar në libër (Leuhul Mahfudh).” (Kuran, 57:22)

Vetëm Allahu e di të ardhmen. Allahu thotë:

“Thuaj: “Askush dhe asgjë tjetër, përveç Allahut, as në qiej e as në tokë nuk e di të fshehtë.” (Kuran, 27:65)

Dhe:

“Askush nuk e di çdo të ndodhë të nesërmen.” (Kuran, 31:34)

Allahu nuk ia ka treguar këtë të fshehtë as të Dërguarit të Vet, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të. Ai thotë:

“Thuaj: “Unë nuk ju them juve se kam depot e Allahut (e t’ju sjell mrekulli), as nuk pretendoj se di të fshehtë, as nuk ju them se jam melek (engiell) ...” (Kuran, 6:50)

Atëherë, ç’janë këta parashikues të së ardhmes?! Ja se si i drejtohet Allahu i Madhëruar të Dërguarit të Tij, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të:

“Thuaju (o Muhamed): “A mos keni ndonjë dije që ta nxirrni para nesh? Ju vërtet mbështeteni vetëm në hamendje; ju vërtet gënjeni.” (Kuran, 6:148)

Allahu i Madhëruar thotë gjithashtu:

“Ata që ju i adhuron përvëç Allahut nuk janë gjë tjetër veç emra, që i pagëzuat ju dhe pasardhësit tuaj. Allahu nuk shpalli ndonjë fakt për ta; vendimi nuk i takon askujt përvëç Allahut dhe Ai urdhëroi që të mos adhuron askënd tjetër dhe asgjë tjetër përvëç Atij, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Kuran, 12:40)

Me të vërtetë “SHUMICA E NJERËZVE NUK E DINË” dhe kështu e bëjnë veten robër të krijesave, të cilat janë si ata, e ndoshta edhe më të dobët se ata.

Të ashtuquajturat parashikime, që dëgjon njeriu në të tilla raste, fusin në jetën e tij frikë, hamendje, dyshim, zhgënjim dhe pesimizëm. Truri i njeriut fillon të besojë lehtësisht çdo fantazi që i thuhet, madje edhe fantazinë që e ka pjellë mendja e tij, mjafton që kjo të mendohet se është në dobi të së ardhmes së tij.

Shpresat e tij fillojnë të varen plotësisht te gjërat e paqena. Edhe sikur nga një cep i largët i nënndërgjegjes t'i thuhet se ajo që beson nuk është e vërtetë, ai do të vazhdojë të besojë edhe më verbërisht. Allahu i Madhërishëm thotë në Kuran:

“Ne do të mbjellim frikë në zemrat e atyre që nuk besuan, sepse ata trillojnë dhe i shoqërojnë Allahut zota të tjerë pa asnjë fakt, prandaj vendi i tyre do të jetë xhehenemi. Sa i shëmtuar është vendi i mizorëve!” (Kuran, 3:151)

Idhujtarët kërkonin ndërmjetës për t’u afruar tek Allahu i Madhëruar, siç thotë Allahu në Kuran:

“Ata (idhujtarët), në vend të Allahut, adhuronin atë që nuk u bënte as keq e as mirë dhe thoshin: “Ata janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu.” (Kuran, 10:18)

Atëherë, Allahu u tha atyre:

“Lutjuni atyre, të cilët i morët për zota, përveç Allahut. Ata nuk kanë as grimcën më të vogël, as në qiej as në tokë.” (Kuran, 34:22)

dhe:

“Lutjuni atyre, të cilët i menduat (për zota), përveç Atij. Ata nuk mund t’ua largojnë prej jush mjerimin dhe as nuk mund t’ia çojnë dikujt tjetër.” (Kuran, 17:56)

Atëherë, ku duhet ta kërkojmë ndërmjetësimin? Vetëm tek Allahu i Madhëruar, duke i besuar vetëm Atij, duke besuar tek i Dërguari i Tij dhe duke iu lutur vetëm Allahut.

Duhet që Allahut t'i lutemi ne vetë, pasi Ai u përgjigjet lutjeve tona dhe është vetëm Allahu që sjell të mirën dhe të keqen. Në qoftë se e kaluara është e dhimbshme dhe e ardhmja është e errët, drejtoju Allahut; kur ndihesh keq, drejtoju Allahut; kur ndien se të gjithë të janë kthyer kundër, drejtoju Allahut; kur të gjithë të kanë kthyer shpinën, drejtoju Allahut.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Lutmeni Mua, që t’ju përgjigjem. Ata që i shmangen adhurimit Tim nga mendjemadhësia, do të hyjnë të poshtëruar në xhehenem.” (Kuran, 40:60)

Por a mundet një njeri i mirë, i gjallë, të lutet për ty? Sigurisht, ai mund të lutet për ty.

A lejohet t'i kërkoresh të lutet për ty? Sigurisht që lejohet. Ti mund t'i drejtohesh atij kur e ke pranë, ai të dëgjon dhe ti e dëgjon atë.

Islami nuk lejon në asnjë mënyrë që t'u drejtohem i a t'u lutemi atyre që nuk i kemi pranë, atyre që nuk janë të gjallë, atyre që nuk na dëgjojnë. Pra, nuk lejohet në asnjë mënyrë t'u drejtohem varreve, tyrbeve, teqeve, njerëzve të ashtuquajtur të mirë që kanë vdekur etj., që ata të ndërmjetësojnë tek Allahu.

Përpara se të ndërronte jetë i Dërguari Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"I ka mallkuar Allahu ata që i bënë faltore varret e Profetëve të tyre."*

T'u drejtohesh dhe t'u lutesh varreve, teqeve, tyrbeve, njerëzve të ashtuquajtur të mirë që kanë vdekur etj., do të thotë t'i shoqërosh Allahut të Madhëruar ortak në adhurime.

E, ky është mëkati më i madh, që e nxjerr njeriun nga Islami, ia fshin veprat e mira dhe përfundimi i tij është përjetësisht në zjarr të xhenemit. Këtë Allahu nuk e fal, vetëm në qoftë se njeriu pendohet.

NJËSIMI I ALLAHUT

SHUMËKUJT PREJ NESH mund t'i bëhet pyetja: *Pse je musliman?*

Ndër përgjigjet që mund të japë është se ka emër musliman, se prindërit e tij kanë qenë muslimanë, se gjyshi apo njëri nga të afërmit e tij ka qenë hoxhë ose se thotë gjithmonë 'Bismilah' kur nis punët e tij. Por a janë këto arsye që dikush të jetë vërtet musliman, po të quhet i tillë?

Shpesh mund të kemi dëgjuar shprehjen ***“La ilahe ilallah Muham-ed resulullah”*** nga të afërmit tanë më të moshuar, nga ndonjë predikues musliman ose e kemi thënë vetë, por kuptimin e saj nuk e kemi ditur dhe nuk e dimë se me çfarë gjëje na obligon ajo.

“La ilahe ilallah Muhamed resulullah” është dëshmia islame, që do të thotë: “Nuk ka zot që meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut”.

Njerëzit gjatë gjithë historisë kanë adhuruar shumë zota të tjerë përveç Allahut, u janë lutur njerëzve të gjallë apo të vdekur, figurave të tyre të hedhura në piktura apo skulptura. U janë lutur atyre për shpëtim e shërim, kanë prerë kurban në emër të tyre, u janë lutur që të ndërmjetësojnë për ta; dikë e kanë konsideruar zot e dikë bir apo bijë të Zotit; të tjerë lusin engjëjt, të tjerë lusin kafshët, pemët ..., e të gjitha këto besime bien ndesh me Islamin.

Dëshmia islame na obligon që të mos adhurojmë askënd përveç Allahut, të mohojmë çdo zot tjetër përveç Allahut dhe të mos i bëjmë Atij ortak në adhurim. Për këtë na ka krijuar Allahu. Ai thotë në Kuran:

“Nuk i krijova njerëzit dhe xhinët vetëm se për të më adhuruar.” (Kuran, 51:56)

Atëherë, si të pranojmë tjetërkënd për bir apo bijë të Tij apo ndërmjetësues tek Ai duke i lutur dhe adhuruar sikurse Zotin? Si mund t’u lutemi të vdekurve nëpër varre dhe të presim kurban në emër të tyre me shpresën se ata do të na ndihmojnë, ndërkohë që Allahu nuk pranon që t’i lutemi dikujt tjetër përveç Tij?

Allahu thotë:

“Dhe nuk kemi dërguar Profetë para teje (o Muhamed), veçse i kemi shpallur se nuk ka zot tjetër përveç Meje dhe më adhuroni.”

“...Adhuroni Allahun e nuk ka zot tjetër përveç Tij.”

Dhe:

“Thuaj, Ai është një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (mbështetet) për çdo nevojë. As nuk ka lindur ndonjë as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë me Të.”
(Kuran, 21:25)

KUPTIMI I JETËS

TITULLI NDOSHTA ËSHTË PAK I HABITSHËM, sepse shumica prej jush kanë një mendim për kuptimin e jetës. Por, a mund t'u jepni përgjigje këtyre pyetjeve: *"Përse linda, kur nuk doja?! Përse askush nuk më pyeti?! Përse nuk zgjodha kombin, racën, gjininë, fizionominë trupore, flokët, sytë, lëkurën?!"*

Përse të gjitha këto m'u dhanë papritur dhe papritur do të më merren?!...

Ju lutemi, mendoni me kujdes rreth këtyre pyetjeve. Le të mundohemi ta kuptojmë këtë gjë, të kuptojmë qëllimin e saj.

Lexues i dashur! Nëse arsyetojmë mirë, do të shikojmë se e gjithë jeta e njeriut përbëhet prej tri fazave kryesore:

- 1) Faza e paralindjes
- 2) Faza e jetës - paslindja
- 3) Faza e pasvdekjes

Mendo mirë dhe do të kuptosh se njeriu nuk zgjedh asnjërën nga këto faza. Ai nuk zgjedh se kur do të lindë, sa do të jetojë dhe po

ashtu nuk zgjedh as se kur do të vdesë. A e di pse kështu? Sepse njeriu nuk ka në dorë asgjë, madje as trupin dhe shpirtin e tij. Po ta kishte në dorë trupin, nuk do të dëshironte t'i plakej kurrë, e nëse do të kishte në dorë shpirtin, nuk do ta nxirrte kurrë nga trupi i tij. Të gjitha këto i ka në dorë Allahu i Plotfuqishëm.

Tani le të përpiqemi t'i analizojmë këto TRI FAZA.

1) FAZA E PARALINDJES - Këtu fshihet shembulli i mrekullueshëm për të kuptuar përse jetojmë dhe çfarë qëllimi duhet të kemi në këtë jetë.

Po të shihnim një foshnjë në barkun e nënës, do të vërenim se ka sy, veshë, gojë etj.. Përse i ka këto, kur dihet që nuk i nevojiten atje? Foshnja me sy nuk ka ç'të shohë, me dorë nuk mund të ushqehet dhe as të shkruajë! Po këmbët përse i ka? Ajo nuk mundet të shkojë askund me to! Pse...?!

Përgjigja është *sepse këto do t'i nevojiten pasi të lindë*. Foshnja me siguri që nuk e di, por do ta kuptojë kur të dalë në këtë botë. Nëse asaj i themi që me gishtat do të shkruajë apo do të shtypë në

kompjuter, ajo do të përgjigjet: ‘Çfarë është ky kompjuter? Mos flisni fjalë pa kuptim!’

Pra, ajo nuk mund ta paramendojë se çfarë e pret në këtë botë. Po kështu është kur dikush thotë se në botën tjetër njeriu nuk do të vdesë asnjëherë, nuk do të flejë, nuk do të lodhet, nuk do të ndiejë uri as etje, por do të ushqehet për shkak të kënaqësisë dhe të shijes, do të ketë pallate prej diamanti, ari dhe argjendi, nuk do të ketë jashtëqitje, por ushqimi do t’i shndërrohet në djersë me erë misku... E, të gjitha këto dhe më tepër se këto do t’i kenë besimtarët në xhenet.

Pra, tani jemi në pozitën e foshnjës dhe na thuhet se ekzistojnë ato që sapo përmendëm më sipër, por ne përgjigjemi: “Ç’janë këto? Mos flisni fjalë pa kuptim!”

Shembulli i jetës së kësaj bote ndaj botës tjetër është si shembulli i jetës së paralindjes krahasuar me botën që jetojmë. Përse na vjen çudi që do të ringjallemi?

A thua Ai, Allahu, që na krijoi për herë të parë, s’mund të na krijojë përsëri?

“...Ata do të thonë: “Kush do të na rikthejë ne në jetë?” Thuaj:
“Ai që *ju krijoi* për të parën herë!” (Kuran, 17:51)

Kur njeriut i thuhet nga Zoti i tij që ta falë namazin në mënyrë që të pastrojë trupin dhe shpirtin e tij, që ta falënderojë Krijuesin e tij, pasi të gjitha këto do t'i nevojiten në botën e ardhshme, njeriut nuk i besohet. Pse nuk e kuptojmë që këto punë dhe vepra do të na duhen më vonë, ashtu siç do t'i nevojiten foshnjës në barkun e nënës dora, syri dhe këmbët kur të dalë në jetë?

Dhe unë ju them se me të vërtetë çdo kusht i Islamit do të na nevojitet më vonë (pasi të vdesim).

Jeta është si një test për t'u plotësuar. Nëse e plotëson ashtu siç duhet, do ta marrësh shpërblimin, “Diplomën”, por nëse hyn në test dhe e humb kohën duke luajtur me të, atëherë do të dëshpërohesh. Nëse sheh një makinë luksoze, a mendon se është formuar ‘rastësisht’? Atëherë? E, si mund ta shohë njeriu atë ‘makinë’ pa menduar se është me miliona herë më i përsosur se ajo? Nëse ajo makinë gërvishtet, nuk mund të rigjenerohet, nuk ka logjikë që të mendojë... E, njeriu përsëri thotë se është krijuar rastësisht! Këtë mund ta thotë

vetëm dikush që nuk di të logjikojë. A nuk e vëren ai se çdo gjë që na rrethon e ka krijuar Zoti për ne, kurse njeriun e ka krijuar të falënderojë e të mos mohojë?

“Pra ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj ju (me shpërblim). Më falënderoni e mos më mohoni.” (Kuran, 2:152)

Kafshët mund të jetojnë pa njeriun, gruri mund të jetojë pa njeriun, edhe drurët e malet, edhe dielli, por njeriu nuk mund të jetojë pa to. Allahu të gjitha i ka bërë për njeriun, kurse njeriun e ka krijuar që ta dëgjojë dhe t'i bindet Atij.

Por dikush thotë: *‘Mua më mjafton që e kam zemrën e mirë dhe nuk i dua të keqen askujt.’* Jo për Zotin, kjo nuk mjafton, sikurse nuk mjafton nëse hyn në punë dhe shefi të thotë të punosh, ndërsa ti i thua: *‘O shef, unë nuk ta dua të keqen dhe as nuk t’i vjedh paratë.’* A thua se do të mjaftonte kjo që ti të marrësh rrogën në fund? ASNJËHERË. Po kështu, nuk mjafton vetëm zemra e mirë dhe të mos t’ia duash të keqen askujt, por duhet të bësh punën tënde.

“E, kush ia dorëzon veten Allahut duke qenë edhe *punëmirë*, ai është kapur për lidhjen më të sigurt dhe vetëm tek Allahu është përfundimi i çështjeve.” (Kuran, 31:22)

2) FAZA E JETËS - Të gjithë ne gjendemi në këtë fazë dhe nuk e dimë kur do të mbarojë jeta jonë. Për këtë arsye ne duhet të punojmë me kohë, t’u përmbahemi urdhrave të Zotit dhe Librit të Tij, nëse duam të shpëtojmë. Zoti nuk na pyeti kur na e dha shpirtin, po ashtu nuk do të na pyesë as kur do të na e marrë atë.

“... dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç’vend (ose kohë) do të vdesë. Allahu është më i dijsmi, më i njohuri.” (Kuran, 63:10)

3) FAZA PAS VDEKJES - Në këtë fazë, ata që kishin dëgjuar urdhrin e Krijuesit të tyre nuk do të frikësohen, por do të gëzohen dhe gjithmonë do të jenë të kënaqur. Ndërsa ata të cilët nuk i dëgjuan urdhrat e Tij, pikërisht ata janë të dështuarit dhe të pikëlluarit. Koha nuk kthehet pas, e tashmja nuk përsëritet më. I mençuri mendon dhe punon, ndërsa mendjelehti dhe i hutuari e humb kohën kot dhe kur i vjen fundi, dëshiron të kthehet në botë e ta përmirësojë gabimin, por nuk do të mundet.

“E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!” Kurrresi (kthim nuk ka), e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distançë periodike) deri në ditën kur ringjallen.” (Kuran, 99-100)

DITA E GJYKIMIT

JOBESIMTARËT MENDOJNË se ata nuk do të ringjallen (për t'u gjykuar).

“Ata që nuk besuan, menduan se kurrsesi nuk do të ringjallen. Thuaj: “Po, pasha Zotin tim, patjetër do të ringjallen dhe do të njiheni me atë që keni punuar, e ajo për Allahun është lehtë!” (Kuran, 64:7)

I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Kush i fton të tjerët në rrugë të drejtë, ka shpërblim siç kanë ata që veprojnë sipas ftesës së tij, pa iu pakësuar atyre asgjë nga shpërblimi.”

Allahu i Madhëruar thotë:

“Ajo (Dita e Gjykimit) është Dita e Vërtetë e kush dëshiron, le t'i kthehet rrugës së Zotit të vet.” (Kuran, 78:39)

Dita e Gjykimit është çasti më i ndjeshëm dhe më i vështirë për njeriun. Atë ditë do të caktohet vendi i njeriut; në xhenet apo në

xhehenem. Po paraqesim tani një përshkrim të shkurtër të etapave të Ditës së Gjykimit, që të zgjohemi nga pakujdesia dhe të përgatitemi për këtë ditë të rëndësishme.

Si të përgatitemi? Duke bërë vepra të mira, sepse veprat e mira do të na mbrojnë nga mundimi në ditën më të vështirë. Në radhë të parë, duhet të shikojmë te vetja jonë, se a ekziston apo jo besimi në këtë ditë. Në qoftë se e besojmë, falënderojmë Allahun e Madhëruar që na bëri të tillë. Nëse jo, atëherë le të shpejtojmë për ta fituar këtë besim.

NDIKIMI QË KA BESIMI NË DITËN E GJYKIMIT NË JETËN E MUSLIMANIT

Besimi në Ditën e Gjykimit ka një ndikim të gjerë dhe të gjithanshëm në jetën e muslimanit. Më poshtë po përmendim një pjesë të ndikimit që ka besimi tek ai. Njeriu i cili beson në Ditën e Gjykimit dhe e di se do të japë llogari për gjithçka, pa dyshim:

-do t'i bindet Allahut dhe urdhrave të Tij, do t'u largohet mëkateve dhe veprave të shëmtuara e do të bëjë një jetë të ndershme dhe të lumtur;

-do të jetë i matur në vepra e në fjalë. Ai gjithmonë do të mendohet mirë para se të bëjë ndonjë vepër apo të thotë ndonjë fjalë. Ai do të përpiqet të veprojë e të flasë gjithmonë drejt;

-do të shtojë veprat e mira, sepse e di sa e vështirë është Dita e Gjykimit dhe e di se në atë ditë njeriun mund ta shpëtojnë vetëm veprat e mira. Atëherë, besimtari i shton veprat e mira; falet, jep lëmoshë, agjëron, i porosit të tjerët për vepra të mira dhe ndalon nga veprat e këqija etj.;

-do të parapëlqejë jetën tjetër më shumë se jetën e kësaj bote. Pa dyshim, ai njeri që e di se Allahu ka përgatitur në xhehenem dënim të përhershëm për jobesimtarët, nuk do ta lakmonte shumë jetën tokësore, sepse ajo është e përkohshme. Ai njeri nuk do të ndikohej shumë nga kjo jetë, por do të përpiqej me të gjitha fuqitë për të fituar ngadhënjimin e madh në jetën tjetër, për të cilin duhet vullnet, punë e lodhje.

VDEKJA

VDEKJA ËSHTE ÇASTI që e ndan njeriun nga kjo jetë dhe është pikënisja e tij për në jetën tjetër. Vdekja është e pashmangshme për të gjithë. Allahu i Madhëruar thotë:

“Gjithkush do ta shijojë vdekjen.” (Kuran, 3:168)

Vdekja e ndan njeriun nga të afërmit, nga familja, nga fëmijët, nga pasuria, nga pozita që ka në shoqëri dhe nga gjithçka që ka lidhje me këtë jetë. Kur njeriu vdes, sheh engjëjt që vijnë për ta përgëzuar, në qoftë se ka qenë besimtar.

“S’ka dyshim se ata që thanë: “Zoti ynë është Allahu”, pastaj nuk u luhatën, atyre u zbresin melaiket (në prag të vdekjes dhe u thonë): “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni, keni myzhde xhenetin që ju premtohej!” (Kuran, 41:30)

Në qoftë se nuk ka qenë i tillë, engjëjt e bëjnë të hidhërohet.

“Sikur t’i kishe parë engjëjt kur ua marrin shpirtin atyre që mohuan (do të shihje tmerr), u binin fytyrave dhe shpinave të tyre (para, prapa): “Shijoni dënimin e djegies!” (Kuran, 8:50)

Kur njeriut i vjen shpirti në fyt, atëherë nuk i pranohet më pendimi. Pas këtij çasti çdo vepër e tij do të mbetet e pandryshuar: në qoftë se ka qenë vepër e mirë, do të mbetet vepër e mirë; në qoftë se ka qenë vepër e keqe, do të mbetet e tillë.

Është mirë që besimtari ta kujtojë gjithmonë vdekjen, sepse ajo e nxit të kryejë vepra të mira. I Dërguari i Allahut ka thënë: *“Kujtojeni shpesh atë që jua prish kënaqësitë; ajo është vdekja.”* Për atë që vdes ka filluar Dita e tij e Gjykimit.

VARRI

KUR NJERIU VDES dhe vendoset në gropën e ngushtë të varrit e mbulohet me dhe, e kur të afërmit e tij largohen për në shtëpitë e tyre, atij nuk i bën më dobi asgjë, përveç veprave të mira që ka bërë në këtë botë. Në këtë çast për të vdekurin fillon jeta shpirtërore, në të cilën nuk mund të veprojë më asgjë; aty ka gjykim dhe pas gjykimit kënaqësi ose dëshpërim. Dy engjëj do ta pyesin njeriun: *‘Kush është Zoti yt? Cila është feja jote? Kush është Profeti yt?’* Në qoftë

se ai ka qenë besimtar, Allahu do t'i japë siguri për të dhënë përgjigje të sakta; në qoftë se ka qenë jobesimtar, nuk mund të përgjigjet, megjithëse mund t'i ketë ditur përgjigjet në këtë jetë. *Në varr besimtari do të jetë i lumtur dhe do ta shohë vendin e tij në Xhenet, kurse jobesimtari do të shohë vendin e tij në zjarr. Atij do t'i ngushtohet varri derisa t'i kërcasin eshtrat. Varri i jobesimtarit do të jetë një gropë zjarri në të.*

RINGJALLJA DHE TUBIMI

KUR T'I FRYHET BRIRIT (SURIT) për herë të parë, do të vdesë gjithçka në tokë. Më pas do t'i fryhet Bririt për herën e dytë, për Ringjalljen, e atëherë njerëzit do të ngrihen nga varret këmbëzbathur dhe pa rroba në trup.

“Dhe i fryhet Surit, kur qe, duke u ngutur prej varrezave paraqiten te Zoti i tyre.” (Kuran, 36: 51)

Askush nuk do ta shikojë tjetrin nga frika, hutimi e tmerri. Pastaj të gjithë njerëzit do të shkojnë për në sheshin e hapur. Secili do të ketë frikë për veten e tij dhe nuk do të shikojë askënd.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet, prej nënës së vet dhe prej babait të vet, prej gruas a burrit të vet dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit i mjafton çështja e vet.” (Kuran, 80: 34-37)

Atë ditë, Dielli do të afrohet mbi kokat e njerëzve dhe atyre do t'u rrjedhë djersa çurg. Ata do të jenë mbushur me brenga e mërzi.

Vetëm besimtarët e çiltër do të jenë të qetë nën hijen e Mëshirëplotit dhe do të pinë ujë nga Haudi (liqeni ku do të pijë ujë umeti i të Dërguarit Muhamed, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

GJYKIMI

PAS QËNDRIMIT TË GJATË NË SHESHIN e hapur dhe pas ndërmjetësimit të Muhamedit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, Allahu i Madhëruar do të urdhërojë që të fillojë gjykimi. Çdo njeri do të shikojë të gjitha veprat që ka kryer në këtë jetë, sido që të kenë qenë ato, të vogla a të mëdha. Ato nuk mund t'i fshihen Allahut të Madhëruar, i Cili thotë:

“...dhe (mëkatarët) thonë: “Të mjerët ne! Ç’libër qenka ky që nuk paska lënë asnjë (vepër) të vogël e as të madhe pa e përfshirë?! Të gjitha veprat që kanë kryer do t’i gjejnë përpara tyre e Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt.” (Kuran, 18:49)

Në Ditën e Gjykimit secili do t'i shikojë veprat e veta dhe do të gjykohet për to. Atë ditë secili do të shikojë mungesat e veta në namaz, në agjërim, në dhënien e lëmoshës. Secili do të shohë mëkatet a krimet e veta. Secili do të gjykohet për pasurinë e vet: si e fitoi dhe ku e shpenzoi; secili do të gjykohet për pasurinë e vet: si e fitoi dhe ku e shpenzoi; secili do të gjykohet për vitet e jetës së vet: për rininë e vet ku e kaloi; secili do të gjykohet për diturinë e vet: a e shfrytëzoi për të bërë vepra të mira apo për të bërë vepra të këqija. Të gjithë ne do të pyetemi për të gjitha këto, prandaj le të bëjmë vepra të mira në këtë botë, që t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve ashtu siç duhet në botën tjetër. Në Ditën e Gjykimit fytyrat e besimtarëve do të jenë të bardha, të ndritshme si Hëna, ndërsa fytyrat e jobesimtarëve do të jenë të zeza, si nata e errët. Allahu i Madhëruar thotë:

“Atë ditë do të ketë fytyra të ndritura, të buzëqeshura e të gëzuara. Atë ditë do të ketë edhe fytyra të mbuluara me pluhur, që i ka pllakosur errësira; ata janë mohuesit, mëkatarët.” (Kuran, 80: 39-42)

XHENETI

PASI TË MBAROJË GJYKIMI, do të vendoset ura e kalimit mbi xhehenem (Sirati). Besimtarët e kalojnë atë me shpejtësi. Ata drejtohen për në xhenet të sigurt e të qetë. Atje i presin engjëjt, të cilët u hapin dyert e xhenetit dhe ata futen në të.

“...ata do t’i vizitojnë engjëjt duke hyrë në secilën derë. (U thonë) Selamun alejkum (paqja qoftë mbi ju!), me durimin tuaj gjetët shpëtimin; sa përfundim i lavdishëm është ky vend.”
(Kuran, 13 : 24-25)

Por, ç’është xheneti? Xheneti është begatia e vërtetë dhe e përhershme. Besimtarët shikojnë në xhenet gjithçka të këndshme e të mirë, që nuk mund të përfytyrohet dot në këtë jetë. Edhe po të përpiqueshim, përfytyrimi nuk do t’i afrohej aspak së vërtetës. Për këtë na mjafton fjala e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të: “Në të (xhenet) ka çfarë nuk janë parë, as janë dëgjuar dhe as që i përfytyron dot njeriu.”

Shpesh ndodh që njeriu bën një jetë të mirë në këtë botë dhe mund t'i duket vetja si në xhenet, por po të kujtojë jetën e përhershme (jetën tjetër), menjëherë kjo jetë dhe begatitë e saj do t'i duken të pavlefshme sepse xheneti është i përkryer dhe i përhershëm; në të nuk ka vdekje. Në këtë jetë njeriu shpesh mërzitet edhe nga të mirat, prandaj kërkon t'i ndërrojë ato, por në xhenet ai nuk mërzitet kurrë. Allahu i Madhëruar thotë:

“S’ka dyshim se ata që besuan dhe bënë vepra të mira, vend-pripte për ta janë xhenetet e Firdeusit.

Aty do të jenë përgjithmonë, e nuk kërkojnë të largohen nga ai (ose t’u ndryshohet).” (Kuran, 18: 107-108)

Pasi të përfundojë gjykimi, edhe jobesimtarët do të dëshirojnë të kalojnë Urën e Siratit njësoj si besimtarët, por engjëjt nuk do t'i lejojnë. Ata do t'i tërheqin jobesimtarët me grepa dhe do t'i hedhin në xhehenem. *A e dini se ç’është xhehenemi?* Xhehenemi është vendi i tmerrit, i ndëshkimit. Në të nuk ka asnjë ndihmë. Atje ka vetëm dhimbje, rënkime e dënime të shumta. Disa nga ndëshkimet e jobesimtarëve në xhehenem janë zjarri përvëlues, gjarpërinjtë dhe

akrepat e mëdhenj, uji i nxehtë që të këput zorrët, pijet e qelbura e të tjera.

I lutemi Allahut të na ruajë nga xhehenemi, nga ky ndëshkim i papërshkrueshëm, të cilin trupi ynë i dobët nuk mund ta përballojë kurrë, qoftë edhe në formën e tij më të lehtë!

I Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “Ndëshkimi më i lehtë në xhehenem do të jetë zjarri poshtë këmbëve të tij dhe nga ai zjarr atij do t’i vlojnë trutë.”

Pra, i dashur vëlla, a nuk duhet të shpëtojmë nga ky ndëshkim? Natyrisht që po, por ky shpëtim vjen vetëm në qoftë se largohemi nga mëkatet dhe i bindemi Allahut të Madhëruar dhe të Dërguarit të Tij.

PSE JAM MUSLIMAN?

PËR RËNDËSINË E KËSAJ TEME flasin vetë shprehjet e njerëzve, të cilët pa të keq pyesin këdo që e njohin apo qoftë edhe rastësisht, nisur nga paraqitja e tij, *pse musliman je ti?!*

Kjo gjë nuk duhet të shqetësojë askënd që me dëshirë dhe bindje është bërë musliman, përkundrazi, i del si detyrë që në formën më të mirë, ashtu siç jemi urdhëruar nga mësimet kuranore, t'ua shpjegojë qartë të tjerëve arsyen pse është musliman.

Së pari, do të thoshim se besimi e ka vendin në zemër dhe askush nuk ta dikton, ndaj të qenët musliman është proces që vjen natyrshëm, kur njeriu ndërgjegjësohet pas leximit, dëgjimit dhe meditimit të thellë.

Arsyeja kryesore që e justifikon të qenët musliman është mënyra se si e njohin dhe e adhurojnë Zotin muslimanët.

Besimi në Zot është pjesë e çdo vetëdijeje njerëzore, qoftë edhe e atyre që mendojnë se nuk besojnë. Madje vetë ata, kur gjenden në

ndonjë vështirësi, Zotit i drejtohen për ndihmë, qoftë edhe instintivisht, fakt ky për ekzistencën e Krijuesit absolut.

Bazat e besimit të Zotit në fenë islame mund të përmbliken si vijon:

1. *E besojmë Zotin si Krijuesi i çdo gjëje, në dorën e Tij gjenden çelësat e mirësive dhe të begatise. Asgjë nuk ndodh në univers, qoftë e mirë apo e keqe, pa lejen e Tij. Ai është i aftë për çdo gjë, mjafton të thotë bëhu e ajo bëhet.*

“Ai është shpikës i qiejve e i tokës (pa kurrfarë modeli të mëparshëm) e kur dëshiron diçka, ai vetëm i thotë: ‘Bëhu!’, në atë moment bëhet.” (Kuran, 2:117)

Mjafton gjithësia, me të dukshmet dhe të padukshmet e saj, si tregues se Allahu ka mundësi për gjithçka. Kjo bindje na qetëson në çdo situatë. Kur jemi në vështirësi, i lutemi, i mbështetemi dhe i frikësohemi vetëm Zotit dhe jo vendeve të ashtuquajtura të shenjta, sepse e dimë se asgjë tjetër nuk ka në dorë as më pak e as më shumë sesa thjesht të qenët veprues të asaj që ka caktuar Ai. Duket i tepërt shpjegimi se përse nuk duhet të shkojmë nëpër tyrbe e vende të

tjera, gjoja të shenjta, sepse çdokush që mendon pak e kupton se i vdekuri nuk ka asgjë në dorë. Sepse po të kishte, muslimanët do t'i bënë tyrbe kudo të Dërguarit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të. Por duke e ditur se tyrbet e shumta vetëm sa i largojnë njerëzit nga lutja dhe lidhja e shpresës vetëm me Zotin, muslimani e lut vetëm Zotin direkt pa shkuar në vende gjoja të mira.

Ata njerëz të cilët ndjekin këtë mënyrë të shkurtër për të lutur Zotin e kanë gabim, sepse kjo formë nuk ka asnjë argument nga feja e Zotit dhe këta njerëz, që edhe pse me qëllim të mirë e bëjnë këtë veprim, kurrë nuk do të gjejnë zgjidhje të problemeve.

Ata që njerëzit adhurojnë përveç Zotit nuk mundën të ndihmojnë a të dëmtojnë po nuk deshi i madhi Zot. Kjo qetësi shpirtërore është veçori dalluese e atyre që me bindje i mbështeten vetëm Krijuesit të tyre dhe vetëm Atij i luten për ndihmë.

2. E besojmë Zotin si një Krijues me emra dhe attribute të përkryera. Ai të sheh çfarë bën, të dëgjon çfarë thua, të shpërblen nëse vepron mirë dhe të ndëshkon nëse nuk i bindesh.

Është e sigurt se çdo gjë që të ka urdhëruar është në të mirën tënde dhe se çdo gjë që të ka ndaluar është në të keqen tënde. Vetëm Ai e ka në dorë furnizimin dhe të ardhmen, ndaj vetëm Atij ia kërkojmë atë që na nevojitet.

Nisur nga këto dhe nga shumë cilësi të tjera, të jesh i bindur se ky Zot e meriton të adhurohet çiltërsisht me dashuri, frikë, shpresë dhe pa hipokrizi.

Pjesë tjetër e rëndësishme si musliman është edhe besimi në Kuranin Famëlartë. Kurani është libri që Zoti ia zbriti me anë të melekut Xhibril të Dërguarit Muhamed, paqja e Zotit qoftë mbi të, mbi të gjithë të Dërguarit para Tij dhe mbi të gjithë ata njerëz që ndjekin rrugën e tij.

Kurani është libër që i mahnit lexuesit, i çudit shkencëtarët dhe i fut në meditime mendimtarët. Të jemi të sinqertë, jo që në leximin e parë Kurani të bën për vete, për shkak të vështirësisë në të kuptuar, ngaqë është i pamundshëm përkthimi i përsosur i tij në gjuhë tjetër. Por nëse do ta lexosh fillimisht shpjegimin që i është bërë, do ta kesh të lehtë për ta kuptuar më pas.

Në këtë libër, Zoti i Madhëruar ia ka sqaruar njerëzimit rrugën që duhet të ndjekë për të qenë i lumtur në këtë botë dhe në tjetrën. Kurani edhe sot ekziston në gjuhën në të cilën është zbritur pa i ndryshuar as edhe një shkronjë, fakt që nuk e mohon askush.

Në të flitet edhe për shumë zbulime shkencore, edhe pse nuk është libër shkencor, por Zoti me anë të këtyre ajeteve dëshiron t'u tregojë njerëzve se ky libër është vetëm prej Tij dhe se njerëzit nuk kanë mundësi ta shkruajnë një libër të tillë.

Kurani është koherent dhe do të mbetet i përshtatshëm për të gjitha kohët. Të fshehtat e tij nuk shteren kurrë. Ai e ndalon njeriun nga çdo e keqe dhe i tregon çdo të mirë. Këtë e dinë mirë ata që e kanë lexuar.

Fakt tjetër bindës që na bën të ndihemi krenarë si muslimanë është edhe historia e lavdishme e Islamit që prej fillimit të tij.

Mjafton të dish se si ndikoi Islami në transformimin e atij populli ku u shfaq. *Ishte ai popull që e përçoi kulturën e tij deri në Evropë, që për hir të së vërtetës ia kushton qytetërimit islam periudhën e rilindjes evropiane. Ishin universitetet islame në Spanjën e asaj kohe vendi ku u*

shkolluan shumë rilindës evropianë. Mora si shembull popullin ku u shfaq Islami rishtazi, sepse aty duket qartë ndryshimi se çfarë mund të bëjë një popull i prapambetur në të gjitha drejtimet në krahasim me kulturën perse, bizantine apo romake të asaj kohe, nëse ai pranon Islamin. Vlen të përmendet edhe fakti se kur muslimanët e zbatonin fenë, jomuslimanët merrnin mësim prej tyre, ndërsa tani ndodh e kundërta. Edhe kjo të bën të mendosh pak për realitetin e kësaj feje.

Pa dashur të zgjatemi akoma me argumentet reale, të cilat na bëjnë të ndihemi të qetë që jemi muslimanë, ju ftoj të lexoni sadopak librat autentikë të kësaj feje, që ta kuptoni realitetin e Islamit e të mos ndikoheni nga çfarë thonë apo bëjnë njerëzit. Askush nuk mund të jetë shembull real i një muslimani të mirë përmes të cilit ti mund të shohësh Islamin e vërtetë, edhe pse janë të shumtë ata që janë të pajisur me cilësi islame.

KARVANI I TË PENDUARVE

NJË SHOK MË THA: -Një ditë u ndala para kalendarit që të grisja letrën që tregonte datën e djeshme dhe të zbuloja datën e radhës dhe papritmas u shtanga kur pashë se deri në fund të vitit kishin mbetur vetëm dy ditë. Mendova me vete: *“Një vit i tërë ka kaluar dhe nga ajo që më kujtohet, nuk kam me çfarë të lavdërohem, pasi gjithçka ka qenë kotësi dhe humbje.”*

Më goditi një ndjenjë tronditëse në zemër, si të ishte rrufe. Filluan të më dridhen gjymtyrët e trupit dhe m'u rrëqeth tërë qenia kur kuptova se kishte kaluar edhe ky vit dhe nuk isha parapërgatitur për vendqëndrimin tim të ardhshëm për të cilin më paralajmëroi kalendar, i cili më vërtetoi edhe një herë gjënë e sigurt që e di çdo njeri.”

Në ato momente, teksa shoku më fliste, m'u kujtuan ajetet e Zotit të Madhëruar në Kuranin Famëlartë:

“Ai thotë: “E sa vjet keni kaluar në tokë?” Ata thonë: “Kemi qëndruar një ditë ose një pjesë të ditës, pyeti ata që dinë

numërimin!” Ai thotë: “Mirë e keni, sikur ta dinit, njëmend pak keni qëndruar!”

Pas këtyre fjalëve, Allahu i Lartësuar thotë:

“A menduat se Ne ju krijuam kot dhe se ju nuk do ktheheni te Ne?” (Mu’minun, 112-115)

Nëse jeta e zakonshme e kësaj bote qenka prej gjashtëdhjetë vitesh deri në shtatëdhjetë, apo le të themi se është edhe dikush që e arrin vitin e njëqindtë, *vallë çfarë vlere kanë ato kënaqësi të cilat bëhen duke hidhëruar Krijuesin dhe duke tejkaluar kufijtë e vendosura, kur fundi pas tërë atyre dëfrimeve do të jetë zjarri?*

Sa ia vlen që t’u gëzohemi kënaqësive dhe të jepemi pas tyre kur fundi i tyre është humbja e përhershme për ne?

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ju njerëz dijeni se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet

dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer, e llomitur...”
(Kuran, 57:20)

O njeri, bashkoju KARVANIT TË TË PENDUARVE që është duke udhëtuar, bashkoju grupit që ndien keqardhje për kohën e humbur kot dhe mos harro se dera e pendimit është ende e hapur për ty, pa marrë parasysht mëkatin dhe gabimin që ke bërë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.” (Kuran, 24:31)

O njeri, vërtet lotët e të penduarve janë të sinqerta, zemrat i kanë të zbutura, i druhen Zotit të tyre, ndiejnë keqardhje për veprat e tyre dhe shpresojnë në mëshirën e Zotit të tyre.

O njeri, kujto rastin e Fudejl ibën Ajadit, i cili ka qenë një njeri i dhënë pas epsheve dhe kënaqësive të kësaj bote. Një natë ai kishte lënë takim me vajzën që dashuronte dhe duke kaluar muret e shtëpive, që të shkonte tek ajo, dëgjon fjalët e Kuranit:

“A nuk është koha që zemrat e atyre që besuan të zbuten me këshillat e Allahut dhe me atë të vërtetën që zbriti (me Kurandin)” (Kuran, 57:16)

Kur dëgjoi këtë ajet, u shtang për një moment dhe iu kujtuan të gjitha tradhtitë, mëkatet, çoroditjet dhe gjërat me të cilat vazhdimisht e hidhëronte Allahun e Lartësuar. Në atë moment filluan t’i rridhnin lotët e pendimit dhe u mbush me shpresën e faljes nga Allahu i Gjithëmëshirshëm. Kështu ai u pendua dhe u largua nga punët e këqija, derisa u bë nga më të devotshmit dhe më të mirët e kohës së tij.

O ti që ke humbur shumë kohë nën hidhërimin e Krijuesit tënd, a nuk ke dëgjuar për hadithin e Muhamedit, lavdërimi dhe pagja qofshin mbi të, i cili thotë: “Allahu gëzohet më tepër kur rob i Tij pendohet sesa nëse ndonjëri prej jush sikur të kishte qenë në një shkretëtirë të madhe me devenë e tij dhe ajo papritmas i humb, e mbi të ka pasur të ngarkuar ushqimin dhe pijen e tij. (Pasi e kërkon) Njeriu humb shpresat se mund ta gjejë dhe shkon dhe shtrihet nën hijen e një druri që të presë vdekjen. Papritmas, kur zgjohet, e sheh

devenë që është kthyer pranë tij. E kap nga kapistra dhe nga gëzimi i madh thotë: “O Allahu im! Ti je rob i im kurse unë jam zoti yt!” Gabon për shkak gëzimit të madh.” (Buhariu dhe Muslimi)

O ti që vazhdon mëkatet dhe je ende i hutuar, kjo thirrje është për ty, nëse dëshiron ta arrish karvanin të cilin ende e sheh tek ecën. Lexo çfarë thotë Zoti i Lartësuar për faljen e mëkateve të tua, edhe nëse janë të shumta sa malet:

“Thuaj: “O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse vërtet Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është që shumë fal dhe është mëshirues.” (Kuran, 39:53)

Pastaj lexo çfarë thotë i Dërguari Muhamed, lavdërimi dhe pagja qofshin mbi të: “Ai që pendohet nga mëkatet është si ai që nuk ka mëkate.” Ndërsa ai për veten e tij thoshte: “O njerëz, pendohuni tek Allahu. Vërtet unë pendohem njëqind herë në ditë.” (Muslimi)

Kënaqësitë e ndaluara të kësaj bote, sado joshëse të jenë, janë të përziera me neveri dhe shëmti gjatë kryerjes së tyre, kurse pas kryerjes ato *gjenerojnë ankth, vuajtje dhe pikëllim*. Pastaj, *mëkati nxin fytyrën,*

ngrys zemrën, errëson varrin, ligështon trupin, pakëson riskun (furnizimin) dhe krijon urrejtje në zemrat e të tjerëve.

Në anën tjetër, vepra E MIRË SHNDRIT FYTYRËN, NDRIÇON ZEMRËN, jep fuqi në trup dhe krijon dashuri në zemrat e të tjerëve ndaj njeriut që e kryen këtë vepër të mirë.

O njeri, ti nuk e di se kur do të të arrijë vdekja dhe sa të ka mbetur nga kjo jetë, ashtu siç nuk e di askush, por prapë ti vazhdon ta shtysh pendimin duke i thënë vetes: “Ka ende kohë, le ta shijoj edhe pak “ëmbëlsirën” e kësaj jete dhe kur të arrij pleqërinë, atëherë do të pendohem.”

Vërtet këto janë mashtrime të shejtanit dhe joshje të botës së përkohshme. NXITO dhe ki kujdes nga hutimi dhe zvarritja para se të bëhet vonë dhe të pendohesh atëherë kur pendimi nuk bën dobi, ashtu si do të thonë ata që nuk janë penduar me kohë:

“Sikur të isha kthyer edhe një herë e të isha bërë prej atyre bamirësve!” (Kuran, 39:58)